



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nënkomisioni Parlamentar për Ndjekjen dhe Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”

PROCEVERBAL

Tiranë, më 21.09.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Nënkomisionit

Rendi i ditës:

- 1.Konstituimi i nënkomisionit .
- 2.Vijueshmëria e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Elona Hoxha, Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

-

Të ftuar

-

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj!

Sot zhvillojmë mbledhjen e Nënkomisionit Parlamentar për Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gradës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

Rendi i ditës i mbledhjes së sotme ka të bëjë së pari, me konstituimin e këtij nënkomisioni parlamentar, i cili është vendosur të ngrihet nga parlamenti pikërisht për të vlerësuar dhe për të monitoruar zbatimin e ligjit për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Paraprakisht do të desha që t’ju relatoj për vendimin e Kuvendit që ka ngritur këtë nënkomision parlamentar. Në datën 5 mars të vitit 2018 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare dhe pas nxjerrjes së dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 10747 të datës 20 mars të vitit 2018, ligji ka hyrë në fuqi në datën 4 prill të vitit 2018.

Në vijim unë desha t’ju bëj me dije se në nenin 67 të ligjit në fjalë parashikohet edhe ngritja e nënkomisionit parlamentar, i cili do të jetë në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Objekti dhe fusha e veprimtarisë së këtij nënkomisioni do të jetë ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Sikurse e dini përbërja, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve të Kuvendit rregullohen nga nenet 18,19,20 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit.

Në vijim të kësaj ju bëj me dije që pikërisht në datën 19.07.2018 Kuvendi i Shqipërisë ka vendosur ta ngrejë nënkomisionin parlamentar për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit që bën fjalë për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit dhe po citoj pjesë nga vendimi:

“ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

1. Të ngrihet Nënkomisioni Parlamentar për Ndjekjen dhe Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme.

2. Nënkomisioni organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit për Sigurinë Kombëtare.

Fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni është ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 12/2018.”

Në pikën 4 të vendimit thuhet: “Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë: Ermonela Valikaj, kryetare e komisionit, vendi i nënkryetarit të këtij komisioni i përket opozitës dhe konkretisht Partisë Demokratike, zoti Pjerin Ndreu, anëtar nga Partia Socialiste, zonja Elona Hoxha, anëtare nga Partia Socialiste, zoti Sadi Vorpsi, anëtar nga Partia Socialiste, ndërkohë që dy postet e tjera, meqenëse nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, i takojnë opozitës”. Pra, nga këta 7 anëtarë, 4 do të jenë anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi të Partisë Socialiste, ndërkohë që 3 vendet e tjera janë të opozitës, por nga ajo që i është bërë me dije opinionit publik opozita deri ditën e sotme që jemi duke folur nuk ka depozituar asnjë emër në Kuvendin e Shqipërisë për të bërë të mundur funksionimin e këtij nënkomisioni me anëtarësi të plotë.

Sidoqoftë, nënkomisioni sot e ka kuorumin për të zhvilluar mbledhjen dhe për të bërë konstituimin e tij, prandaj do të deklaroja në vijim të vendimit të Kuvendit konstituimin e Nënkomisionit Parlamentar për Ndjekjen dhe Mbikëqyrjen e Zbatimit të ligjit për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit.

Si detyrë e parë e nënkomisionit është zgjedhja e sekretarit të nënkomisionit, prandaj do t'i ftoja kolegët deputetë të bëjnë propozimin përkatës për zgjedhjen. Kuptohet që monitorimi i zbatimit të ligjit për vetingun në radhët e Policisë së Shtetit përbën një domosdoshmëri, natyrisht është edhe një detyrë jona e ngarkuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Do të ishim të nderuar t'i kishim në komision edhe kolegët e opozitës, por shpresojmë që ata t'i bashkohen këtij nënkomisioni, meqenëse ka qenë kërkesa e tyre edhe gjatë diskutimeve që ne kemi pasur në komision që të ngrihej një nënkomision i tillë me përbërjen e të gjitha partive politike që marrin pjesë në Kuvend. Posaçërisht, grupi i deputetëve të përfaqësuar nga LSI-ja e ka mbështetur këtë amendim edhe në Kuvendin e Shqipërisë, sepse një ndër kushtet e tij për të votuar pro ligjit të vetingut në radhët e

policisë ka qenë pikërisht reflektimi i këtij propozimi çka u bë e mundur nga Kuvendi i Shqipërisë, nga maxhoranca.

Sidoqoftë, Kuvendi i Shqipërisë do të ketë mbledhjen e radhës ditën e hënë, prandaj shpresojmë që kjo mbledhje të jetë edhe si një lloj thirrjeje për opozitën që ajo të depozitojë emrat e anëtarëve të saj në mënyrë që komisioni të funksionojë i plotë.

Ju lutem kolegë, vazhdojmë me propozimet për zgjedhjen e sekretarit të komisionit!

Pjerin Ndreu – Unë propozoj që zoti Sadi Vorpsi të jetë sekretar i këtij komisioni.

Gjithashtu, rezervoj të drejtën t’ju them dy fjalë. Ky komision, si për mua, edhe për të gjithë kolegët e mi është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me vetingun në polici. Më vjen shumë keq që opozita nuk ndodhet e pranishme, megjithëse në retorikën e saj çdo ditë dhe çdo orë flet për vetingun, nuk merr pjesë as në vetingun që po bëhet në drejtësi dhe as në polici. Kjo është një shfaqje mjaft e ulët e opozitës, sepse vetingu në polici është pjesë e atij sistemi të drejtësisë, që ne duhet ta reformojmë. Pa një sistem drejtësie të reformuar, ne nuk mund të pastrojmë dhe reformojmë askënd, prandaj unë i ftoj kolegët opozitarë të vijnë në komision dhe të kontribuojnë në këtë çështje mjaft të rëndësishme, në pastrimin e Policisë së Shtetit nga elementët e inkriminuar, që ata po i anatemojnë çdo ditë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Do të doja të dëgjoja nga kolegët, nëse janë dakord me këtë propozim.

Atëherë, biem dakord që sekretari i Nënkomisionit Parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””, të jetë zoti Vorpsi.

Në këtë mënyrë, mund të themi se kryetari dhe sekretari i këtij nënkomisioni janë të zgjedhur, ndërkohë që vendi i zëvendëskryetarit i përket opozitës.

Mbledhja e sotme është një mbledhje e karakterit formal, sepse ajo ka të bëjë me konstituimin e këtij nënkomisioni.

Do të doja të bëj me dije kolegët se ndërkohë, ne kemi komunikuar me Ministrinë e Brendshme. Mbledhja e radhës do të jetë në ditën më të parë të punës së komisioneve parlamentare që, sipas vendimit të Kuvendit të Shqipërisë, i takon të jetë dita e martë. Në këtë ditë ne do të jemi së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme për të parë se si ka ecur zbatimi i ligjit për vetingun në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, për të parë nëse është

zgjedhur Bordi Përzgjedhës dhe më pas, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, të cilat janë dy organet që duhet të zgjidhen që në fillim të zbatimit të ligjit, pikërisht për të filluar me vlerësimin që nga gradat e larta të Policisë së Shtetit, që në mos gaboj bëhen rreth 300 punonjës.

Ditën e martë do të jemi këtu për të parë se deri në çfarë pike është shkuar, nëse është ngritur Bordi Përzgjedhës dhe nëse janë paraqitur kandidaturat pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ose jo. Natyrisht, për këtë do të na duhet prezenca e përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme.

Do të pyes kolegët nëse kanë diçka për të shtuar. Këtu do të fokusohet detyra jonë në ditët në vijim, në mënyrë që me pyetjet dhe me nxitjen tonë të bëjmë të mundur që ky ligj kaq i rëndësishëm të mund të zbatohet, se për vetingun flasim çdo ditë.

E rëndësishme është të mos flasim thjesht dhe vetëm për populizëm, por ato që themi, të mund t'i zbatojmë për të siguruar maksimumin e figurave më të pastra në Policinë e Shtetit, mënyrë kjo që natyrisht, do të shërbejë si një mekanizëm shumë i fortë edhe për luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit, që janë dhe dy format më të ndeshura të krimin dhe që përbëjnë një sfidë jo vetëm për shoqërinë shqiptare, por për të gjitha shoqëritë në përgjithësi.

Ju faleminderit!

Mbledhja tjetër do të zhvillohet ditën e martë!

MBYLLET MBLEDHJA